

## MARRËVESHJE PËR SHITJE KUOTE

Kjo marrëveshje për blerje kuote nënshkruhet sot me date 06.01.2022 midis dhe nga palët e mëposhtme:

- A. **Shoqëria NDREGJONI Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Njesia bashkiak nr.8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr.32, Kati 11, Hyrja 8, Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K31329048I, përfaqësuar nga Administratori Z. **Xhetan Ndregjoni**, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (këtu e tutje referuar si "Shitësi");


dhe

- B. **Shoqëria Marina di Valona Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Lobby Home, Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, përballë TEG, Farkë, Lundër, Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: M01324008A, përfaqësuar nga Administratori Z. **Ervin Baçaj** (këtu e tutje referuar si "Blerësi").

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si me poshtë:

vijon:

1. Shitësi gjeson të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **100 LEK** (njëqind lekë), e cila përfaqëson **10%** (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "**Shoqëria Koncessionare Marina Vlorë**" sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, themeluar me date 27.08.2021, regjistruar ne QKB me NUIS M12027029I, dhe seli ne **Lobby Home, Rruga Nacionale, Tirane – Elbasan, Fark, Lunder, Tirane** (referuar si 'Shoqëria'), përfaqësuar nga Administratori Znj. Eranda Muskaj ("**Kuota**").
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër që ky i fundit zotëron në Shoqëri dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gjeson si ortak, ja kalon Blerësit, i cili pranon t'í blejë, për një çmim të barabarte me **100 LEK** (njëqind lekë) (këtu e tutje referuar si "Çmimi").
3. Shitësi deklaron se Blerësi i ka paguar Shitësit çmimin e pote në ditën e firmosjes se kësaj marrëveshje.
4. Shitësi deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguruese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe ne cdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të këtë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e Kuotës së mësipërme. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e Kuotës.
6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, Shitësi nuk gjeson më asnjë të drejtë ose titull mbi Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përsa i përket pronësisë dhe posedimit, do të gjëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gjeson të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.
7. Me finalizimin e transferimit të Kuotës, Blerësi Marina di Valona shpk bëhet zotërues i Kuotës që përbën 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.



8. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
9. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
10. Kjo marrëveshje hyr në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

**NË DËSHMI TË PALËVE**, kjo marrëveshje u hartua në 2 (dy) kopje origjinale me nga 2 (dy) faqe secila, nga palët, të cilat me leximin e saj nënshkruajnë aktin në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

#### PALËT KONTRAKTORE

Shitësi



Blerësi

